



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 22, datë 07.10.2021

MBI

“MIRATIMIN E RREGULLORES TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”, pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores të funksionimit të Komisionit të marrëdhënieve me studentët në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Rektorit me nr. 151, datë 17.09.2021, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores të funksionimit të Komisionit të marrëdhënieve me studentët në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

UN

**RREGULLORE E KOMISIONIT TË
MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 22, Datë 07/10/2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE E KOMISIONIT TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Baza ligjore e rregullores

Rregullorja e Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët të Universitetit të Arteve mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të tij, në legjislacionin në fuqi si dhe në Statutin e Universitetit të Arteve. Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët ngrihet për të garantuar dhe për të zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të Universitetit të Arteve dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në Rregulloren e tij, të miratuar nga Senati Akademik i UART.

Neni 1

Objekti

“Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët” është një strukturë e ngritur pranë Universitetit të Arteve që shërben për të siguruar një nivel cilësor të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët, pedagogët përkatës si dhe njësitë e brendshme të ngritura në këtë institucion. Kjo njësi funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e UART, rregulloren e përgjithshme të UART dhe vendimeve/akteve të tjera të aprovuara në Senatin Akademik të Universitetit të Arteve.

Neni 2

Përbërja

Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik (nga një anëtar për çdo fakultet), 3 anëtarë përfaqësues të studentëve (nga një anëtar për çdo fakultet) dhe 1 përfaqësues nga sektori mësimor & kurikulës. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Përfaqësuesi nga sektori mësimor & kurikulës emërohet nga Rektori.

Mandati bëhet i pavlefshëm kur:

1. Për anëtarët personel akademik:
 - a) Jep dorëheqjen;
 - b) Largohet nga puna;
 - c) Ka mospërputhje me detyrat e tjera që mund të marrë.
2. Për anëtarët Student:
 - a) Jep Dorëheqjen;





- b) Përfundon statuti i tij si student.
- 3. Për përfaqësuesin e sektorit mësimor & kurikulës:
 - a) Jep dorëheqjen;
 - b) Largohe nga puna;
 - c) Ka mospërputhje me detyrat e tjera që mund të marrë.

Neni 3

Misioni

Misioni i këtij komisioni të përhershëm është garantimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis organeve drejtuese të Universitetit të Arteve dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Ky komision bashkërendon punën e stafit pedagogjik, administrativ dhe studentëve si dhe të monitoron zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese për gjithë procesin mësimor në aspektin e mësimdhënies dhe mësim nxënies. Ai raporton për nivelin cilësor të realizimit të tyre dhe informon Dekanatet dhe Rektoratit në problematikat e hasura, arritjet, të metat, si dhe propozon për rrugët dhe mjetet për përmirësimin e tyre. Çdo vit akademik ky komision brenda muajit dhjetor i paraqet një raport me shkrim senatit.

Neni 4

Detyrat

1. Komisioni ushtron këto funksione:
 - a) harton politikat për trajtimin e studentëve;
 - b) bashkëpunon me Këshillin Studentorë dhe koordinon punën me ta;
 - c) propozon mbështetjen financiare dhe logjistike të projekteve të studentëve;
 - d) kërkon informacione të ndryshme nga njësitë kryesore për probleme të studentëve;
 - e) kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre;
 - f) orienton studentët që në bashkëpunim me organet drejtuese, të marrin pjesë në aktivitete sociale, kulturore, akademike, sportive etj.;
 - g) bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Komisionet e tjera të përhershme të ngritura nga Universiteti i Arteve;
 - h) lehtëson komunikimin mes studentëve dhe stafit administrativ e akademik të Universitetit të Arteve;
2. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.
3. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në këtë Rregullore, të miratuar nga Senati Akademik i UART.

Neni 5

Instrumentat

Komisioni, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij, përdor instrumentat e mëposhtëm:

- a) Anketime të studentëve që ndjekin programet e studimeve dhe të Alumni;





- b) Anketime të vlerësimit të didaktikës, të kurrikulës, të mësuarit;
- c) Pyetje konceptuale;
- d) Intervista;
- e) Diskutime në Grup;

Neni 6

Përpunimi i anketimeve

Të gjitha anketimet përpunohen sipas një modeli të miratuar nga komisioni. Përpunimi i anketimeve dhe vlerësimi i pedagogëve, shoqërohet me një raport të hollësishëm. Të gjitha materialet e anketimeve, i vihen në dispozicion Senatit Akademik të UART. Këto rezultate shpallen dhe ju vihen në dispozicion Fakulteteve dhe Departamenteve. Zyra e burimeve njerëzore e Rektoratit ruan raportet e anketimeve.

Neni 7

Bashkëpunimet

Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët mund të krijojë dhe inkurajojë bashkëpunime me institucione të tjera universitare dhe jo universitare, për të dhënë dhe për të shkëmbyer eksperiencën nga më të mirat dhe për të mbështetur iniciativën bashkëpunimi në fushën e arsimit, të artit dhe shkencës.

Neni 8

Marrëdhëniet me Këshillat Studentore

Komisioni i Marrëdhënieve me studentët mban kontakte të rregullta me Këshillin Studentor të UART duke u informuar për problematikat dhe kërkesat e Studentëve.

Neni 9

Mënyra e Funksionimit

1. Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët zhvillon mbledhje periodike të paktën 1 herë në muaj.
2. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Komisioni ka vendosur ndryshe.
3. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datën dhe orën e vendosur për mbledhjet, i njoftohet të paktën 48 orë përpara datës së mbledhjes çdo anëtar të Komisionit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
4. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 5 ditë përpara datës së thirrjes së mbledhjes, si edhe njoftimeve nëpërmjet telefonit.
5. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet nëpërmjet postës elektronike të paktën 24 orë para datës së vendosur për mbledhjen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

6. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të Komisionit nëpërmjet postës elektronike të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.
7. Mbledhjet jashtë radhe mund të organizohen me kërkesë me shkrim të paktën nga 3 anëtarë të këtij komisioni.
8. Vendimet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të votuara nga 50%+1 të anëtarëve.
9. Raporti quhet i miratuar kur është votuar me shumicë të cilësuar.
10. Komunikimi me anëtarët e Komisionit dhe me institucionet e tjera bëhet me shkrim ose me anë të email-it.
11. Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët, zgjedh mes anëtarëve të tij, me votim kryetarin.
12. Kryetari propozohet nga anëtarësia ose mund të vetëkandidohet.
13. Komisioni zgjedh mes anëtarëve një Sekretar që është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve.
14. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretaria e Komisionit dhe firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
15. Sekretaria ruan Bllokun e Procesverbaleve si dhe dokumentet e tjera.

Neni 10 Ndryshimi i Rregullores

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore dhe të Statutit të UART.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UART.

